



### VENDIM

Nr.118 Datë. 01.12.2014

### PËR

## FILLIMIN E PROÇEDURAVE TË LICENSIMIT TË SHOQËRISË “POWER ELEKTRIK SLLABINJE” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 gërma “a”; 9 dhe 13 pika 1, gërma “d” të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “g”; 5 pika 2; 8, 10/3 ; të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 01.12.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Power Elektrik Sllabinje” sh.p.k. si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

### Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “POWER ELEKTRIK SLLABINJE” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave” si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm:

- Neni 9, pika 1  
Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte
- Neni 9, pika 2  
Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Neni 9, pika 3  
Dokumentacioni finaciar dhe fiskal është i plotësuar pjesërisht.( Mungon vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave)

Të dhënat specifike sipas tipit të licensës për aktivitetin e Tregimit të Energjisë Elektrike :

- Neni 9, pika 4/10, germa a, b dhe c janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte
- Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plote/te Pjesëhem dhe Rinovimit të Liçensave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, të paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë **“Power Elektrik Sllabinje” sh.p.k.**, për licencimin në aktivitetin e Tregimit të Energjisë Elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

## VENDIM

Nr.118 Datë. 01.12.2014

## PËR

**FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENSIMIT TË SHOQËRISË “POWER ELEKTRIK SLLABINJE” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.**

Anëtarët e Bordit

Pro

Kundër

Petrit Ahmeti

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Adriatik Bego

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Abaz Aliko

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Entela Shehaj

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Maksim Shuli

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

